



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.08.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Multi Business Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare”, me Nr. të Prok: 632-21-2626-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “Multi Business Group” SH.P.K., e dt. 23.08.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare”, me Nr. të Prok: 632-21-2626-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 16.08.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 16.08.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Multi Business Group” SH.P.K. me datë 23.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare”, me Nr. të Prok: 632-21-2626-5-1-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik “**BM Group**”sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se nuk që tenderi me çmimin me te ulet ne mesin e tetnderëve që plotësojnë kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Faton Gutaj
Menaxher i Zyres së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyres së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës